



LIGJ

Nr.10 352, datë 18.11.2010

PËR ARTIN DHE KULTURËN

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme, rregullat e organizimit, të funksionimit, realizimit dhe financimit të artit e të kulturës, si dhe të drejtat e detyrimet e subjekteve, që kanë për objekt veprimtarie artin dhe kulturën.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është nxitja, mbështetja dhe zhvillimi i krijimtarisë e i veprimtarisë së subjekteve të artit e të kulturës për krijimin, ekzekutimin dhe kultivimin e veprave të të gjitha gjinive të artit dhe kulturës.

Neni 3

Subjektet dhe fusha e zbatimit

Ky ligj zbatohet për të gjithë personat fizikë e juridikë, vendas e të huaj, që ushtrojnë veprimtari në fushën e prodhimit dhe të shfaqjes së veprës artistike kulturore në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Art" është forma e pasqyrimit të botës nëpërmjet riprodhimit të realitetit në mënyrë krijuese me anë figurash artistike dhe veprimtaria artistike.
2. "Fond publik i artit dhe kulturës" është fondi buxhetor që krijohet nga shteti për mbështetjen dhe fuqizimin e artit e të kulturës në vend, i cili ka rol të drejtpërdrejtë në rritjen e klimës artistike dhe të produktit artistik e kulturor.
3. "Kulturë", në kuptimin më të gjerë të saj, përfshin:
 - a) tërësinë e tipareve shpirtërore, materiale, intelektuale dhe emocionale të një shoqërie apo të një grupi shoqëror;
 - b) fushën e zhvillimit shoqëror, që përfshin krijimtarinë e gjithanshme në gjuhë, art, letërsi, në shkencë dhe në tërë jetën shpirtërore.

KREU II

INSTITUCIONET E ARTIT DHE TË KULTURËS

Neni 5

Ndarja e institucioneve të artit e të kulturës

1. Institucionet e artit dhe të kulturës janë subjekte publike dhe private.
2. Institucionet publike të artit e të kulturës ndahen në qendrore dhe vendore.
3. Në institucionet publike qendrore të artit e të kulturës, subjekt i këtij ligji, përfshihen:
 - a) Teatri Kombëtar;
 - b) Teatri Kombëtar i Operës, Baletit dhe Ansambllit Popullor;

c) Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Teatri i Kukullave;

ç) Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës;

d) Galeria Kombëtare e Arteve;

dh) Cirku Kombëtar;

e) Teatri Kombëtar i Komedisë.

4. Në institucionet publike vendore të artit e të kulturës përfshihen institucionet e artit dhe kulturës, në varësi të njësisë së qeverisjes vendore.

KREU III

INSTITUCIONET PUBLIKE QENDRORE TË ARTIT DHE TË KULTURËS

Neni 6

Statusi dhe qëllimi i veprimtarisë

1. Institucionet publike qendrore të artit dhe të kulturës janë persona juridikë, publikë, me statusin e institucionit qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

2. Institucionet publike qendrore të artit dhe të kulturës kanë si qëllim dhe objekt kryesor të veprimtarisë së tyre:

a) nxitjen e zhvillimin e artit, si krijimtari shpirtërore;

b) ruajtjen e identitetit kulturor kombëtar, nëpërmjet studimit, edukimit, prodhimit, paraqitjes dhe shpërndarjes së veprave artistike e kulturore;

c) eksperimentimin e formave të reja të shprehjes skenike;

ç) realizimin e veprave artistike të autorëve shqiptarë dhe të huaj, për të gjitha grupet e shtresat sociale;

d) shkëmbimet teatrore ndërkombëtare, turnetë, festivalet, manifestimet intelektuale, riprodhimin audioviziv dhe botimet.

Neni 7

Drejtimi dhe funksionimi i institucioneve publike qendrore të artit dhe të kulturës

- 1.** Drejtimi dhe funksionimi i institucioneve publike qendrore të artit dhe të kulturës realizohen në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të akteve nënligjore në zbatim të tij, të statutit të institucionit, rregullores së bordit artistik e të rregullores së brendshme të funksionimit.
- 2.** Statuti propozohet nga titullari i institucionit në konsultim me bordin artistik dhe miratohet nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën.
- 3.** Rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit të artit e të kulturës miratohet nga titullari, ndërsa rregullorja e bordit artistik miratohet nga vetë bordi në mbledhjen e parë të tij.
- 4.** Struktura dhe organika e institucioneve publike qendrore të artit e të kulturës miratohen me urdhër të Kryeministrit, pas propozimit të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.
- 5.** Institucioni ka stemën, vulën dhe selinë, të cilat përcaktohen në statut.
- 6.** Institucionet e artit dhe të kulturës nuk mund të ndryshojnë destinacionet e mjediseve të tyre, për të cilat ato janë krijuar.

Neni 8

Organet drejtuese

Drejtimi dhe organizimi i veprimtarisë administrative dhe artistike të institucioneve publike qendrore të artit e të kulturës realizohen respektivisht nga titullari i institucionit dhe bordi artistik.

Neni 9

Titullari

- 1.** Titullari i institucionit publik qendror të artit dhe kulturës ka mandat 4-vjeçar dhe ushtron këto kompe tenca:
 - a) është përfaqësuesi ligjor i institucionit në marrëdhënie me të tretët;
 - b) drejton veprimtarinë administrative dhe organizative të institucionit dhe ndjek zbatimin e vendimeve të bordit artistik;
 - c) administron burimet financiare të institucionit;
 - ç) zgjedh dhe emëron personelin;

d) kryen të gjitha detyrat e tjera që i ngarkon ky ligj dhe statuti.

2. Mënyrat dhe procedurat e ushtrimit të kompetencave të titullarit përcaktohen në statut.

3. Emërimi i titullarit të institucionit publik qendror bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave pas procedurave të konkurrimit të zhvilluara nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën.

4. Lirimi dhe shkarkimi, para përfundimit të mandatit, i titullarit të institucionit publik qendror të artit dhe kulturës bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, për shkelje të ligjit.

Neni 10

Bordi artistik

1. Bordi artistik është organizëm kolegjal vendimmarrës pranë institucionit publik qendror të artit dhe të kulturës. Mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve përcaktohet në statutin e institucionit. Titullari i institucionit thërret, organizon dhe drejton mbledhjet e bordit artistik.

2. Bordi artistik funksionon në përputhje me ligjin nr.8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".

3. Bordi artistik përbëhet nga 7 anëtarë, nga të cilët një përfaqësues nga Ministria e Financave dhe një përfaqësues nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, ndërsa anëtarët e tjerë janë personalitete të shquara të fushës së artit dhe të veprimtarive shoqërore, që kanë lidhje me të. Anëtarët miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin, me propozimin e titullarit të institucionit publik qendror të artit dhe të kulturës dhe nuk mund të jenë të punësuar në institucionin pranë të cilit funksionon ky bord. Mandati i tyre është 4-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

4. Anëtari i bordit artistik, përpara marrjes së çdo vendimi, është i detyruar të nënshkruajë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se nuk ka konflikt interesi, në kuptim të ligjit nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", dhe të dispozitave të tjera ligjore në fuqi.

5. Bordi artistik mblidhet sa herë gjykohet e nevojshme nga titullari i institucionit gjatë një sezoni artistik.

6. Masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 11

Kompetencat e bordit artistik

Bordi artistik i institucionit qendror të artit dhe të kulturës ka këto detyra:

- a) miraton, në mbledhjen e parë, rregulloren e funksionimit të tij, e cila propozohet nga titullari i institucionit;
- b) miraton repertorin artistik vjetor të institucionit, në përputhje me politikën e ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën;
- c) miraton projektet artistike, në përputhje me repertorin e vendosur;
- ç) miraton kriteret dhe masën e shpërblimit të cilësisë artistike për çdo vepër që do të realizohet;
- d) miraton paraqitjen ose pjesëmarrjen e institucionit në festivale e manifestime të tjera, duke përcaktuar edhe projektin pjesëmarrës.

Neni 12

Burimet e financimit

1. Burimet e financimit të institucioneve publike qendrore të artit dhe të kulturës janë:

a) Buxheti i Shtetit, ku përfshihen:

i) financime nga Buxheti i Shtetit për shpenzimet operative e administrative, për investimet e për pajisjet teknike për administratën;

ii) financimi i përftuar nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën për realizimin e repertorit vjetor;

b) të ardhurat nga administrimi i kapitaleve fizike të tyre, si të arkivave, literaturës etj., dhe nga shitja e biletave;

c) të ardhurat e siguruara nga shitja e veprave artistike e kulturore të prodhuara, tek të cilat ushtrohen të drejtat ekonomike e tregtare;

ç) të ardhurat e tjera, të siguruara nga aplikime në burime ligjore financimi për projekte të ndryshme dhe të veçanta, në përputhje me statutet e tyre;

d) sponsorizimet dhe donacionet;

dh) të ardhura të tjera të ligjshme.

2. Përdorimi i të ardhurave bëhet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

3. Tarifat për të ardhurat e krijuara nga veprimtaria kryesore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 13

Marrëdhëniet juridike të punës

Marrëdhëniet juridike të punës në institucionin publik qendror të artit dhe të kulturës rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë dhe me statutin e rregulloren e brendshme të institucionit.

Neni 14

Përfshihet nga zbatimi i dispozitave të kreut III të këtij ligji Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës.

KREU IV

ORGANIZIMI DHE FUNKSIONIMI I QENDRËS KOMBËTARE TË ARTIT DHE KULTURËS

Neni 15

Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës

1. Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës (QKAK) është person juridik, publik, me statusin e institucionit qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, që ka objekt të veprimtari së menaxhimit e fondit publik për mbështetjen financiare të projekteve të paraqitura nga persona fizikë apo juridikë, privatë, vendas ose të huaj, që kanë objekt veprimtarie artin dhe kulturën.
2. Struktura dhe organika e QKAK-së përcaktohen me urdhër të Kryeministrit, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.
3. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të QKAK-së përcaktohet në statut, i cili miratohet nga ministri i përgjegjës për artin dhe kulturën, në bazë të propozimit të kryetarit të Qendrës.

Neni 16

Kryetari

QKAK-ja drejtohet nga kryetari, i cili emërohet, lirohet ose shkarkohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

Neni 17

Kompetencat e kryetarit

Kryetari i Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës ka këto kompetenca:

- a) përgatit dhe thërret mbledhjet e bordit artistik të QKAK-së;
- b) zbaton vendimet e bordit artistik dhe lidh kontratat me subjektet përfituese të fondeve financiare;
- c) përfaqëson institucionin në marrëdhëniet me të tretët;
- ç) ushtron kompetencat për drejtimin e veprimtarisë administrativo-ekonomike të QKAK-së dhe të gjitha kompetencat që nuk i janë dhënë, shprehimisht, bordit artistik.

Neni 18

Bordi artistik i QKAK-së

1. Pranë QKAK-së krijohen bordet artistike, sipas gjinive të artit e të kulturës. Bordi artistik i çdo gjinie të artit funksionon në përputhje me ligjin nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike".
2. Bordi artistik ka këto detyra:
 - a) përzgjedh dhe klasifikon projektet e artit nga pikëpamja e vlerave artistike dhe ekonomike;
 - b) miraton kriteret e regjistrimit të subjekteve të artit;
 - c) përcakton tarifat e aplikimit.
3. Bordi artistik merr vendime me shumicë të thjeshtë votash të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
4. Vendimi i bordit artistik përfshin miratimin e projektit artistik e kulturor dhe fondin financiar përkatës në të gjitha fushat e artit dhe të kulturës dhe për të gjithë aplikantët, që kanë të drejtë të përfitojnë fonde, sipas këtij ligji.
5. Bordi artistik mblidhet sa herë e gjykon të nevojshme titullari i institucionit ose një e treta e bordit.
6. Masa e shpërblimit të anëtarëve të bordit përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 19

Përbërja e bordit artistik të QKAK-së

1. Bordi artistik, sipas gjinive të artit dhe të kulturës, kryesohet nga Kryetari i QKAK-së dhe ka në përbërje nga 5-7 anëtarë për secilin bord. Në përbërje të tij ka personalitete të të gjitha gjinive të artit, si dhe një përfaqësues të Ministrisë së Financave e një përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën.

2. Anëtarët, sipas fushave përkatëse, miratohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, me propozimin e Kryetarit të QKAK-së.

Neni 20

Fondi publik i Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës

Fondi i Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës është buxhetor. Ky fond administrohet sipas rregullave të përcaktuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën dhe, për mbështetjen e projekteve artistike, nuk i nënshtrohet legjislacionit për prokurimet publike.

Neni 21

Kompetencat e Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës

Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës ka këto kompetenca:

a) zbaton politikat shtetërore në fushën e artit dhe të kulturës, në përputhje me këtë ligj dhe me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;

b) shpall publikisht, në fillim të çdo viti, fondin publik të artit dhe të kulturës jo më vonë se një muaj pas përcaktimit me hollësi të Buxhetit të Shtetit;

c) administron dhe planifikon fondin publik të artit, sipas fushave të artit dhe gjinive të artit, mbështet e financon, plotësisht ose pjesërisht, veprimtaritë artistike bashkëkohore dhe veprat e tjera artistike e kulturore përmes projekteve të paraqitura nga personat fizikë e juridikë, në përputhje me programin e Këshillit të Ministrave dhe me politikat e ministrisë përgjegjëse për artin;

ç) paraqet çdo vit kërkesat për mbështetje buxhetore të fondit publik të artit dhe të kulturës, si dhe mbikëqyr përdorimin e financimeve nga subjektet e mbështetura prej saj;

d) mbledh, përpunon dhe u shpërndan subjekteve të artit dhe të kulturës të dhëna të vlefshme në fushat e prodhimit, të edukimit dhe të promovimit të veprimtarisë artistike e kulturore;

dh) nxit, bashkëpunon, financon ose bashkëfinancon projekte e programe në fushën e edukimit, të prodhimit dhe të shpërndarjes së veprimtarive artistike e kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare;

e) regjistron subjektet e artit dhe të kulturës, sipas kërkesave dhe kritereve profesionale të miratuara nga bordi artistik;

ë) siguron asistencë teknike, në shërbim të rritjes cilësore dhe të standardizimit të aplikimit të projekteve teatrore;

f) regjistron subjektet e artit, sipas kritereve të miratuara nga bordi artistik.

Neni 22

Burimet e financimit të QKAK-së

1. Burimet e financimit të Qendrës Kombëtare të Artit e Kulturës janë:

a) financime nga Buxheti i Shtetit, për projektet e artit e të kulturës, për investimet, pajisjet teknike për administratën, si dhe për shpenzimet operative administrative;

b) të ardhurat nga tarifatat për regjistrimin e subjekteve aplikuese për financimin e projekteve të artit e kulturës;

c) sponsorizimet dhe donacionet;

ç) të ardhura të tjera të ligjshme.

2. Tarifatat për të ardhurat e krijuara nga veprimtaria kryesore përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 23

Kushtet dhe kriteret për gëzimin e së drejtës së aplikimit

1. Institucioni publik vendor i artit e kulturës, personi fizik apo juridik, privat, gëzon të drejtën e aplikimit për financim nga fondi publik i artit dhe kulturës vetëm pasi është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Artit dhe Kulturës. Kushtet dhe kriteret e aplikimit përcaktohen dhe miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

2. Subjektet private të artit dhe kulturës, të cilat përfitojnë financime nga fondi publik i artit dhe kulturës, janë të detyruara të kontraktojnë artistë dhe bashkëpunëtorë për realizimin e projektit.

3. Shpenzimet administrative të një projekti artistik, të financuar nga fondi publik i artit dhe kulturës, nuk duhet të kalojnë 15 për qind të të gjithë vlerës së financimit.

Neni 24

Llojet e financimeve nga Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës

1. Institucioni publik vendor i artit dhe kulturës, personi fizik apo juridik, privat, gëzon të drejtën të kërkojë nga Qendra Kombëtare e Artit dhe Kulturës financim, të pjesshëm ose të plotë, për një projekt artistik e kulturor, afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër.

2. Përcaktimet për këto lloj projektesh miratohen nga bordi artistik i QKAK-së.

Neni 25

Të drejtat pasurore për veprën e realizuar nga subjekti privat i artit dhe kulturës

Pasi ka shlyer detyrimet, që burojnë nga financimi, parashikuar në kontratën me Qendrën Kombëtare të Artit dhe Kulturës, subjekti përfitues i fondit, me statusin e institucionit publik vendor të artit dhe të kulturës, personi fizik apo juridik, privat, gëzon të drejtën pasurore dhe jopasurore dhe të përdorimit të lirë të veprës artistike e kulturore, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.9380, datë 28.4.2005 "Për të drejtën e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me të", të ndryshuar.

KREU V

FINANCIMI I PROJEKTEVE DHE I VEPRIMTARIVE ARTISTIKE E KULTURORE NGA MINISTERIA PËRGJEGJËSE PËR ARTIN DHE KULTURËN

Neni 26

Financimi i projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore

1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, nga fondi buxhetor i miratuar çdo vit, financon:

a) projekte artistike e kulturore, me synim ruajtjen e trashëgimisë dhe vlerave kombëtare, në funksion të politikave kulturore të përvitshme, si festivale, konkurse kombëtare, veprimtari jubilarë, promovime dhe botime kolonash;

b) projekte dhe veprimtari artistike e kulturore, të cilat, sipas rëndësisë së tyre, i kalojnë përmasat e projekteve të zakonshme dhe që kanë një buxhet që arrin mbi 40 për qind të fondit vjetor për projekte.

2. Ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.

3. Procedurat, që ndiqen për financimin e projekteve artistike, sipas shkronjës "b" të pikës 1 të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 27

Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore

1. Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën bëhet nga ministri, me propozim të kolegjiut, të përbërë nga nëpunës të nivelit të mesëm dhe të lartë, drejtues të strukturave përgjegjëse që mbulojnë secilën nga gjinitë e artit, dhe i cili ka këto kompetenca:

a) miraton festivalet, sipas kritereve të vendosura me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën;

b) për nxitjen e krijimtarisë artistike kombëtare, i propozon ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën shpalljen e konkurseve kombëtare të përvitshme në fushat e artit, sipas gjinive;

c) miraton veprimtari artistike-kulturore të ministrisë përgjegjëse për artin dhe kulturën, në përputhje me përcaktimet e bëra në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 26 të këtij ligji.

2. Mënyra e funksionimit të këtij kolegji përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

KREU VI

INSTITUCIONET PUBLIKE VENDORE TË ARTIT DHE TË KULTURËS

Neni 28

Institucionet publike vendore të artit e të kulturës dhe statuti i tyre

1. Institucionet publike vendore të artit e të kulturës janë institucione buxhetore, që krijohen ose shndërrohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në zbatim të këtij ligji me nismën e vullnetin e pushtetit vendor dhe janë në varësi të njësisë së pushtetit vendor.

2. Statuti i institucionit publik vendor të artit e të kulturës propozohet nga bordi artistik dhe miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

3. Përbërja e bordit artistik të institucionit publik vendor miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore. Anëtarët e bordit kanë mandat 4-vjeçar, me të drejtë ripërsëritjeje.

4. Institucioni publik vendor i artit dhe kulturës e ka selinë në njësinë administrative vendore.

Neni 29

Burimet e financimit të institucioneve publike vendore të artit dhe të kulturës

Burimet e financimit të institucionit publik vendor të artit dhe të kulturës sigurohen nga:

a) financime nga Buxheti i Shtetit për pushtetin vendor për shpenzimet administrative;

b) buxheti i pushtetit vendor për kulturën;

c) të ardhurat e siguruara nga projektet fituese në Qendrën Kombëtare të Artit e Kulturës;

ç) të ardhurat nga shitja e veprës artistike e kulturore;

d) të ardhurat nga biletat, shërbimet që institucioni u bën të tretëve;

dh) sponsorizimet e donacionet;

e) të ardhura të tjera të ligjshme.

Neni 30

Zgjedhja e titullarit

1. Titullari i institucionit artistik e kulturor publik vendor emërohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore dhe përzgjidhet ndërmjet dy kandidaturave të fushave të artit, të propozuara nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore.

2. Kriteret e emërimit të titullarit të institucionit artistik e kulturor publik vendor përcaktohen në statutin e këtij institucioni, i cili miratohet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.

Neni 31

Marrëdhëniet juridike të punës

Marrëdhëniet juridike të punës në institucionin publik vendor të artit dhe të kulturës rregullohen me Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë, si dhe me aktet nënligjore, statutin dhe rregulloren e brendshme.

Neni 32

Financimi i teatrit publik vendor

1. Teatrot publikë vendorë përfitojnë 30 për qind nga fondet për kulturën që shpërndan pushteti qendror për pushtetin vendor.

2. Miratimi për përdorimin e grantit bëhet nga këshilli i njësisë së qeverisjes vendore.

KREU VII

SUBJEKTET PRIVATE TË ARTIT DHE TË KULTURËS

Neni 33

Subjektet private të artit dhe të kulturës

1. Subjektet private të artit e të kulturës funksionojnë në mbështetje të ligjit nr.9901, datë 14.4.2008 "Për shoqëritë tregtare" dhe ligjit nr.8788, datë 7.5.2001 "Për organizatat jofitimprurëse".

2. Subjektet private të artit e të kulturës detyrohen të regjistrohen në QKAK dhe në organet tatimore, në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi, në mënyrë që të përfitojnë financime për projekte private nga fondi publik i artit dhe kulturës.

3. Procedurat dhe tarifat e regjistrimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën subvencionon nga fondi buxhetor i saj subjekte private të artit e të kulturës, që funksionojnë si shoqëri tregtare ose organizata pa qëllime fitimi, të cilat zhvillojnë veprimtari të pasur artistike. Kushtet dhe masa e subvencionimit të këtyre subjekteve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VIII

TARIFAT E SHPËRBLIMIT TË CILËSISË ARTISTIKE

Neni 34

Masa dhe kriteret e shpërblimit

1. Masa e shpërblimit të gjinive artistike, sipas fushave të artit dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet artistike, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Ministri përgjegjës për artin dhe kulturën shpall zhvillimin e konkurseve kombëtare në të gjitha gjinitë e artit. Kushtet dhe masa e shpërblimit të fituesit përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.

3. Kushtet, kriteret dhe masa e shpërblimit për rezultate të larta, të arritura në konkurrime ndërkombëtare për artin e kulturën, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU IX

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 35

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, 16, 18, 26 e 34 të këtij ligji.

2. Kryeministri miraton, brenda 6 muajve, në bazë të propozimit të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën, organikën e Cirkut Kombëtar, të Teatrit Kombëtar të Komedisë dhe të Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës.

Neni 36

Shfuqizime

Ligji nr.9631, datë 30.10.2006 "Për artin skenik" dhe të gjitha aktet nënligjore, që bien në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 37

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6792, datë 6.12.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**



LIGJ

Nr. 25/2014

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 10 352, DATË 18.11.2010,
“PËR ARTIN DHE KULTURËN”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 10 352, datë 18.11.2010, “Për artin dhe kulturën”, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

Neni 1

Në nenin 5, pika 3, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “ç” shfuqizohet.

2. Shkronja “e” ndryshohet si më poshtë:

“e)Teatri kombëtar eksperimental “Kujtim Spahivogli”;

Neni 2

Neni 14 shfuqizohet.

Neni 3

Kreu IV, “Organizimi dhe funksionimi i Qendrës Kombëtare të Artit dhe Kulturës”, shfuqizohet.

Neni 4

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

Financimi i projekteve dhe veprimtarive artistike e kulturore

1. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, nga fondi buxhetor i miratuar për çdo vit, financon:

a) projekte të paraqitura nga persona fizikë, juridikë,

vendas ose të huaj, që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre artin dhe kulturën;

b) projekte dhe veprimtari artistike e kulturore, të cilat konsiderohen të rëndësishme së veçantë dhe që kanë një

buxhet që arrin mbi 40 për qind të fondit vjetor për projekte.

2. Ky fond nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik.

3. Procedurat, që ndiqen për financimin e projekteve artistike, sipas shkronjës “b”, të pikës 1, të këtij neni, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 5

Neni 27 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 27

Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore

1. Miratimi i veprimtarive artistike e kulturore për artin dhe kulturën bëhet nga ministri përgjegjës për artin dhe kulturën, me propozimin e kolegjiut, të përbërë nga:

a) personalitete të gjinive të ndryshme të artit, të përcaktuara me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën;

b) nëpunës civilë të nivelit të lartë dhe të mesëm, drejtues të strukturave përgjegjëse, që mbulojnë secilën nga gjinitë e artit në ministrinë përgjegjëse për artin dhe kulturën.

2. Kriteret dhe afatet në lidhje me kërkesë-propozimet për mbështetje financiare, të parashikuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 26, përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”.

Neni 6

Pas nenit 27 shtohet neni 27/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 27/1

Kompetencat e kolegjiut

1. Kolegjiut ka këto kompetenca:

- a) përzgjedh dhe klasifikon projektet e artit nga pikëpamja e vlerave artistike, kulturore, edukative sociale dhe ekonomike;
- b) miraton veprimtari artistike-kulturore për artin dhe kulturën, në përputhje me përcaktimet e bëra në nenin 26 të këtij ligji;
- c) nxit krijimtarinë artistike kombëtare dhe i propozon ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën organizimin e konkurseve kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit.

2. Mënyra e funksionimit të kolegjiut përcaktohet me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”.

Neni 7

Kreu VII, “Subjektet private të artit dhe kulturës”, shfuqizohet.

Neni 8

Në nenin 34, pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, në zbatim të politikave të saj, organizon konkurse kombëtare dhe skema të tjera vlerësimi në gjini të ndryshme të artit.

Kushtet dhe masa e shpërblimit të fituesit përcaktohen me urdhër të ministrit përgjegjës për artin dhe kulturën.”.

Neni 9

Dispozita kalimtare dhe të fundit

Aktet nënligjore që bien në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohen.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 20.3.2014

**Shpallur me dekretin nr. 8531, datë 3.4.2014 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bujar Nishani**